



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit dhe të bashkakuarve dëshmitarët vazhduan të japin dëshmi këtë javë.

Të hënën dha dëshmi dëshmitari i 70-të i thirrur nga Prokuroria. Sipas përmbledhjes që lexoi Prokuroria, dëshmitari i mbrojtur ishte anëtar i LDK-së, i cili ishte arrestuar bashkë me një person tjetër, dhe të cilin e kërcënuan dhe rrahën.

Pas përfundimit të dëshmisë së tij të martën, Nuhi Bytyçi, një gazetar që mbuloi luftën në Kosovë, filloi dëshminë, e cila vazhdoi dje dhe sot.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 31 maj, Paneli i Apelit hodhi poshtë një apel të z. Krasniqi dhe z. Selimi me të cilin kundërshtuan pranimin e deklaratave të dëshmitarëve të dhëna para TPNJ-së dhe Prokurorisë Speciale në Kosovë. Trupi Gjykues vuri në dukje se jurisprudenca e gjykatave dhe tribunalëve ndërkombëtarë përputhet me konstatimin e Trupit Gjykues se pranimi i deklaratës së një të bashkakuar nuk shkel të drejtat e të akuzuarit për gjykim të drejtë, përderisa vlera provuese e deklaratës nuk zhbëhet prej efektit dëmtues nga pranimi i saj. Paneli i Apelit konstatoi se aspekti kryesor është se sa peshë duhet t'u jepet, nëse do t'u jepet, këtyre deklaratave dhe këtë vendim mund ta marrë vetëm Trupi Gjykues në fund të gjykimit, pasi të ketë shqyrtuar të gjitha provat përkatëse.

Gjithashtu më 31 maj, Trupi Gjykues hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për të mos e lejuar një dëshmitar të dëshmonte në lidhje me pjesëmarrjen e pretenduar personale të z. Thaçi në arrestimin dhe/ose keqtrajtimin e disa personave të identifikueshëm, sepse ky pretendim nuk është ngritur nga Prokuroria. Trupi Gjykues kujtoi konstatimin e vet të mëparshëm se nuk do t'i kushtojë vëmendje këtij pretendimi, për pjesën që lidhet me pjesëmarrjen e pretenduar personale të z. Thaçi, dhe theksoi se provat që mund të kenë lidhje me një pretendim që nuk është paraqitur në Aktakuzë mund të pranohen nëse kanë të bëjnë edhe me pretendime të tjera që janë paraqitur në Aktakuzë, ose me faktet nën shqyrtim në gjykim.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 3 qershor, Trupi Gjykues hodhi poshtë kërkesën e z. Krasniqi për të apeluar vendimin me të cilin u pranua në prova deklarata e një dëshmitari që nuk mund të paraqitet në sallën e gjyqit. Në deklaratë, dëshmitari identifikon z. Krasniqi në një vend të krimit që lidhet me akuzat e ngritura nga Prokuroria. Trupi Gjykues konstatoi se të akuzuarit kanë pasur dhe do të kenë mundësi të marrin në pyetje të paktën gjashtë dëshmitarë të tjerë që japin dëshmi lidhur me të njëjtat rrethana dhe vendosi se Mbrojtja nuk ka vërtetuar se ky aspekt do të ndikonte konsiderueshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë dhe në rezultatin e gjykimit.





Në çështjen *Januzi dhe të tjerët*, më 5 qershor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi kërkesën e Mbrojtjes së Bahtijarit për zgjatje të afatit për dorëzimin e dosjes paraprake nga ekipet e Mbrojtjes, duke e zgjatur atë deri më 20 qershor 2024. Gjykatësi i Procedurës Paraprake caktoi gjithashtu 5 korrikun 2024 si datë paraprake për t'ia kaluar dosjen e çështjes gjyqësore Trupit Gjykues.

Më 5 qershor, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëroi në vendime më vete për secilin, vazhdimin e paraburgimit për Sabit Januzin dhe Haxhi Shalën. Ai konstatoi se për të dy të akuzuarit vazhdon të ekzistojë rreziku që të arratisen, pengojnë ecurinë e procesit dhe të kryejnë krime të tjera, dhe se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk ka në dispozicion kushte të tjera të arsyeshme që mund t'i vendosë për të zvogëluar në masën e duhur rreziqet ekzistuese.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 4 qershor, Administratorja njoftoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake për miratimin me kusht të z. Xhon Kabon (John Cubbon) si bashkëmbrojtës të Haxhi Shalës.

Gjithashtu më 4 qershor, Administratorja informoi Gjykatësin e Procedurës Paraprake për caktimin me kusht të z. Ian Eduards si mbrojtës të z. Isni Kilaj, pas kërkesës për ndihmë juridike në bazë të Rregullores për Ndihmë Juridike të Dhomave të Specializuara.

Më 31 maj, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese lëshoi vendimin lidhur me kërkesën referuese të Nasim Haradinajt, i cili pretendon shkelje të të drejtave dhe lirive të tij individuale në lidhje me procesin penal kundër tij para Dhomave të Specializuara të Kosovës. Në vendim, Dhoma Kushtetuese e shpalli të papranueshme një pjesë të ankesave së tij dhe hodhi poshtë pjesën tjetër, duke konstatuar se nuk ishte shkelur Kushtetuta e Republikës së Kosovës ose Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Vendimin mund ta gjeni në faqen e internetit të DHSK-së.

Më 6 qershor, gjykatësi Nikola Giju njoftoi Kryetaren Trendafilova për dorëheqjen e tij nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë. Gjykatësi Giju dha dorëheqjen nga Regjistri për të marrë detyrat si gjykatës në Gjykatën Penale Ndërkombëtare.

Po të njëjtën ditë, gjykatësja Marjorie Masselot u emërua në Regjistrin e Gjykatësve dhe bëri betimin solemn. Kryetarja lëshoi vendime për zëvendësimin e gjykatësit Giju me gjykatësen Masselot në rolin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake në çështjet gjyqësore *Januzi dhe të tjerët* dhe të Gjykatësit të Vetëm në lidhje me hetimet aktuale.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje

